



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 33, datë 28.01.2021

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 e 89 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionin dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DIBËR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Murat Lleshi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Drejtimit i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR MAT

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Ardit Kuka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 278/1, 84, 274 të Kodit Penal”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Edvan Veçani, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 110/2 dhe 278/1 të Kodit Penal”.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Xhevdet Lika, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen penale me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Mat; I pandehur: {...}; Objekti: “Dërgim i çështjes në gjyq”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KUKËS

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Enkeleda Dalipi dhe Aulon Pashaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen penale me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës; Të pandehur: {...}; Objekti: “Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura, parashikuar nga neni 102/2 i Kodit Penal”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Sami Ujkashi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen civile me Paditës: {...}; I paditur: {...}; Objekti: “Heqja/kufizimi i zotësisë për të vepruar, Heqje e përgjegjësisë prindërore”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Ariola Kristo, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; I pandehur: {...}; Akuza: “Vjedhje me dhunë”, parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Seladin Pysqyli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; Të pandehur {...}; Akuza: “Plaçosje e rëndë me dashje, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 88 e 25 të Kodit Penal”.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË VLORË

1. Gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, Elidon Papazisi dhe Ema Shaholli, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, çështjen civile me Paditës: {...}; I paditur: {...}; Objekti: “Detyrimin e palës së paditur për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga begatimi pa shkak i saj në shumën 3.718.003 lekë, e cila përfaqëson vlerën e punimeve shtesë për objektin Rikonstruksion i ish Godinës së Riparimit të mjeteve të rënda dhe magazinës së rikuperove pranë parkut të naftës’.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË DURRËS

1. Gjyqtarja e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Nafije Hasko, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, çështjen civile me Paditës: {...}, etj.; Të paditur: {...}”; Objekti: “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 40, datë 27.05.2019, nr. 8, datë 27.05.2019 dhe nr. 36, datë 27.05.2019 të Këshillit Bashkiak Prrenjas, etj”.

GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, Margarita Buhali, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale me të pandehur {...} “Vjedhje”.

2. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, Engert Pëllumbi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Shkatërrim i pronës nga pakujdesia”.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Nazmi Troka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Shpërdorim detyre”.

4. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Sokol Ngresi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Mashtrimi kryer në bashkëpunim”.

5. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Nazmi Troka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Trafikim i narkotikëve” dhe “Shpërdorim detyre”.

6. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, Margarita Buhali, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale me të pandehur{...}; Akuza: “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”.

7. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, Laurent Fuçia, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Viktima{...}; Akuza: “Mashtrim”.

8. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, Laurent Fuçia, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale me të pandehur{...}, etj.; Akuza: “Kultivim i bimëve narkotike”.

9. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Skënder Damini, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen gjyqësore me Ankues: {...}o; Objekti: “Rishikim vendimi penal”.

GJYKATA E APELIT KORÇË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Edlira Petri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Drejtim automjeti në mënyrë të parregullt, etj”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Elona Toro, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Organizim ose ushtrim të veprimtative të lojrave në kundërshtim me ligjin”.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Edlira Petri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur{...}; Akuza: “Prodhim dhe shitje narkotikësh”.

4. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Elona Toro, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec; I pandehur: {...}; Objekti: “Dërgim i çështjes në gjyq”.

5. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Edlira Petri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur{...}; Akuza: “Ndihmë për kalim të paligjshëm kufiri”.

GJYKATA E APELIT VLORË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Irena Brahim, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen penale me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë; I pandehur: {...}; Akuza: “Falsifikim i dokumentave”, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal.

2. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Sokol Pina (relator) si dhe gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Enton Dhimitri dhe Miranda Andoni, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Ankues: {...}; Kundër: {...}; Objekti: “Prishje e vendimit datë 26.06.2020 të Prokurorisë së Rrethit Lushnje “Për mosfillimin e procedimit penal”, sipas materialeve të regjistruara në kallëzimin nr. 526, datë 18.06.2020”.

GJYKATA E APELIT DURRËS

1. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, Erjon Çela, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Rebelimi i të burgosurve” dhe “Shkatërrimi i pronës me zjarr”, parashikuar nga nenet 270/2 dhe 151 të Kodit Penal.

GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Miranda Andoni, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}; “Nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/1, 334/1 të Kodit Penal”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Genti Shala, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 333/a/1, 140-22 dhe nenet 28/4 e 334/1, 140 dhe nenet 28/4 e 334/1, 88, 88 dhe nenet 28/4 e 334/1 dhe 278/2 të Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR